



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 948/1 prot.

Tiranë, më 23.09.2021

V E N D I M

Nr.118, datë 23.09.2021

***“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Mallakastër, të filluar me urdhrin e brendshëm nr. 49, datë 07.07.2021, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.*”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Mallakastër,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 49 (Nr. 733 prot.), datë 07.07.2021, “Për verifikimin e rasteve të emërimit në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Mallakastër”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit me këtë objekt në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Mallakastër.

Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Mallakastër është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 10, datë 14.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës organizative dhe niveleve të pagave të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësi, për vitin 2021”.

Duke analizuar përmbajtjen e strukturës dhe organikës së Bashkisë Mallakastër, vërehet se nuk evidentohen qartësisht pozicionet të cilat përfshihen në skemën e shërbimit civil, për faktin se rezultojnë të mos jenë emërtuar në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në vijim të analizës së strukturës organizative, Komisioneri konstaton se, në skemën e shërbimit civil të Bashkisë Mallakastër janë përfshirë pozicione pune që kryejnë funksione të njësive publike direkte të shërbimit, konkretisht pozicionet të cilat renditen si më poshtë:

- 3 (tre) Specialist i zyrës me një ndalesë;
- 1 (një) Specialist informacioni, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse (receptionist);
- 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Arsimit dhe Shëndetit Parësor;
- 1 (një) Specialist i çështjeve arsimore;
- 1 (një) Specialist i çështjeve shëndetësore.

Në kuptim të nenit 2, pika “e”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, personeli i njësive publike direkte të shërbimit, pranë njësive të qeverisjes vendore, përjashtohet nga skema e shërbimit civil. Në nenin 4, pika “dh”, të po këtij ligji, përcaktohet se, njësi publike direkte shërbimi është njësia administrative që kryen drejtpërdrejt për qytetarët shërbimet publike të arsimit parauniversitar e universitar, kujdesit shëndetësore, kulturës, sportit, artit, ndihmës sociale dhe shërbimet e tjera shoqërore.

Në lidhje me sa më sipër, njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, me miratimin e strukturës së ardhshme të institucionit, duhet të analizojë detyrat dhe kompetencat për pozicionet e mësipërme të punës, për të përcaktuar nëse këto pozicione kryejnë funksione të njësive publike direkte të shërbimit dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e tyre ose jo, në skemën e shërbimit civil.

Në strukturën aktuale të Bashkisë Mallakastër, janë konstatuar raste të pozicioneve të punës, të cilat në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil, nuk janë përfshirë në skemën e shërbimit civil. Konkretisht bëhet fjalë për pozicionet e punës të cilat paraqiten me emërtesën:

1. Specialist pyjesh, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit (4 pozicione);
2. Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile dhe Territorit.

Në lidhje me pozicionin e punës “Specialist pyjesh”, njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, duhet të analizojë detyrat dhe funksionet nëpërmjet hartimit të përshkrimeve të punës, duke marrë në konsideratë përcaktimet e nenit 6 dhe nenit 7, pika 3/1, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, si dhe përcaktimet e Lidhjes nr. 3,

të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, ku në ndarjen me numër rendor 8, në kolonën e tretë, përcaktohet se:

“pozicionet e punës, të cilat kanë si përshkrim pune hartimin, zbatimin e politikave të mbarështimit pyjor, ruajtjen, zhvillimin e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për përdorimin dhe shfrytëzimin, zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore..., përfshihen në skemën e shërbimit civil”.

Njësia përgjegjëse së bashku me aktorët e ngarkuar nga ligji, duhet të ri-klasifikojnë pozicionet e mësipërme, si pozicione që përfshihet në skemën e shërbimit civil dhe me pas, të marrë masa për plotësimin e tyre, në pëprthje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërsa në lidhje me pozicionin e punës “Drejtor”, në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile dhe Territorit, i cili aktualisht trajtohet si pozicion jashtë skemës së shërbimit civil, Komisioneri vëren se ky pozicion është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë, e cila sipas strukturës aktuale përbëhet nga këto njësi organizative:

- Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit;
- Policia Bashkiake;
- Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri;
- Sektori i Mbrojtjes Civile (*emergjencat civile*).

Në referencë të legjislacionit në fuqi, rezulton se pozicionet e punës, të cilat kryejnë funksionet e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, ndërsa pozicionet e punës që kryejnë funksionet e emergjencave civile (*Sektori i Mbrojtjes Civile*) klasifikohen si pozicione pjesë e shërbimit civil.

Në kushtet kur, pozicioni i punës “Drejtor i Mbrojtjes Civile dhe Territorit” mbulon menaxhimin e kësaj drejtorie, ku ndër të tjera siguron zbatimin e legjislacionit përkatës si në fushën e mbrojtjes së territorit edhe atë të emergjencave civile, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, duhet të ndajë këto funksione nga njëra tjetra, duke analizuar detyrat e secilit funksion dhe në përfundim të këtij procesi, të përfshijë në skemën e shërbimit civil, pozicionin e punës, i cili do të kryejë funksionet e emergjencave civile.

Për sa më sipër, në analizë të strukturës aktuale të institucionit, Komisioneri kërkon të sjellë në vëmendje të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Mallakastër, se duhet të tregojë kujdes në krijimin e një strukture organizative, në të cilën duhet të evidentohen qartësisht pozicionet e shërbimit civil, si dhe lidhja hierarkike midis tyre. Njëkohësisht, duhet të tregohet kujdes

edhe gjatë krijimit të njësisë organizative, të tilla si drejtori apo sektorë, me qëllim që në përbërje të tyre të grupohen pozicione të cilat kryejnë detyra dhe funksione të së njëjtës fushë.

Njëkohësisht, me qëllim krijimin e një strukture organizative në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vlerësohet se, në strukturën e Bashkisë Mallakastër duhet të parashikohet pozicioni i punës i cili duhet të kryejë detyrat e nëpunësit më të lartë civil, me qëllim që të garantohet ligjshmëria e procesit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe të procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit.

Gjatë miratimit të strukturës së institucionit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, duhet të ketë në konsideratë faktin se, trajtimi dhe përfshirja e një pozicioni pune, në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, duhet të analizohet duke e lidhur me detyrat dhe funksionet e pozicionit konkret, kjo në referencë të legjislacionit përkatës dhe jo me të dhënat apo karakteristikat konkrete të punonjësit që ushtron detyrën në këtë pozicion.

Ndryshimet e mësipërme, duhet të gjejnë pasqyrim edhe në Rregulloren e Brendshme të institucionit, pasi rezulton se aktualisht, Bashkia Mallakastër ushtron veprimtarinë e saj me rregulloren e miratuar me vendimin nr. 1, datë 18.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë Mallakastër”, në përmbajtje të së cilës nuk reflektohen ndryshimet e strukturës organizative, miratuar me vendimin nr. nr. 10, datë 14.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të verifikimit, konkretisht strukturës organizative të institucionit, listëprezencës dhe listëpagesën për muajin qershor 2021, u konstatuan 24 pozicione të shërbimit civil, të plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi, duke mos u respektuar procedura e rregullt e konkurrimit. Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm”, emëruar me aktin nr. 452, datë 21.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
2. ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Njesisë së Integritit Europian”, emëruar me aktin nr. 137, datë 31.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
3. ***** , në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Njesisë së Integritit, emëruar me aktin nr. 27, datë 28.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
4. ***** , në pozicionin “Specialist i ndihmës ekonomike”, në Njesisë Administrativ Ballsh, emëruar me aktin nr. 391, datë 10.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;

5. *****, në pozicionin “*Specialist i dhunës në familje, mbrojtjes së fëmijëve, barazisë gjinore dhe mbrojtjes sociale*”, emëruar me aktin nr. 390, datë 10.08.2020 të Kryetarit të Bashkisë;
6. *****, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, me aktin nr. 843, datë 02.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
7. *****, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore”, emëruar me aktin nr. 97, datë 28.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
8. *****, në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Sektorin Juridik, emëruar me aktin nr. 94, datë 28.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
9. *****, në pozicionin “*Specialist transporti*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 167, datë 25.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
10. *****, në pozicionin “*Specialist inxhinier*”, në Sektorin e Planifikimit, Projektimit dhe Lejeve të Ndërtimit, emëruar me aktin nr. 407, datë 27.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
11. *****, në pozicionin “*Specialist zyre*”, në Sektorin e Kadastrës, emëruar me aktin nr. 454, datë 21.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
12. *****, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shërbimit Veterinar*”, emëruar me aktin nr. 69, datë 30.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
13. *****, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektori të Pyjeve dhe Mjedisit*”, emëruar me aktin nr. 441/1, datë 09.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
14. *****, në pozicionin “*Specialist pyjesh dhe zonave mbrojtura*”, emëruar me aktin nr. 459, datë 24.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
15. *****, në pozicionin “*Specialist pyjesh dhe zonave të mbrojtura*”, emëruar me aktin nr. 96, datë 09.4.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
16. *****, në pozicionin “*Specialist muzike*”, emëruar me aktin nr. 453, datë 21.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
17. *****, në pozicionin “*Specialist muzike*”, në Sektorin e Kulturës, Sportit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 145, datë 04.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
18. *****, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Kulturës, Sportit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 384, datë 10.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
19. *****, në pozicionin “*Specialist i turizmit*”, në Sektorin e Kulturës, Sportit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 315, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
20. *****, në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Njësinë Administrative Fratar, emëruar me aktin nr. 60, datë 01.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
21. *****, në pozicionin “*Specialist kadastre, agronom*”, në Njësinë Administrative Fratar, emëruar me aktin nr. 1, datë 05.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
22. *****, në pozicionin “*Specialist i tatim taksave*”, në Njësinë Administrative Fratar, emruar me aktin nr. 330, datë 30.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë;

23. *****, në pozicionin “*Specialist pyjesh dhe zonave të mbrojtura*”, në Njësinë Administrative Fratar, emëruar me aktin nr. 110, datë 30.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
24. *****, në pozicionin “*Specialist protokollit*”, emëruar me aktin nr. 77, datë 19.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Mallkastër, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Në referencë të dokumentacionit të administruar rezulton se, me urdhrin nr. 48, datë 19.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë, është miratuar plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil, në përmbajtje të së cilës konstatohet se është parashikuar zhvillimi i

procedurave të konkurrimit për 26 pozicione të lira, sipas strukturës aktuale të Bashkisë Mallakastër.

Gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga institucionet e vetëqeverisjes vendore, gjatë administrimit të shërbimit civil, për periudhën Janar – Qershor 2021, Bashkia Mallakastër ka informuar Komisionerin në lidhje me paligjshmërinë e procedurës së emërimit për punonjësit *****, *****, ***** dhe *****. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit në subjekt, është konstatuar se:

- Punonjësi *****, ka qenë i emëruar në pozicionin “*Specialist topograf*”, me aktin nr. 30, datë 22.01.2018.

Rezulton se, me miratimin e strukturës së re, pozicioni “*Specialist topograf*” është riklasifikuar, duke mos u trajtuar si pozicion i shërbimit civil. Në lidhje me këtë nëpunës, konstatohet se është rregulluar gjëndja e paligjshmërisë së procedurës së emërimit, por nga ana tjetër, Komisioneri konstaton se, miratimi i strukturës së re nuk shoqërohet nga relacioni i njësisë përgjegjëse, në të cilën të jenë analizuar detyrat dhe funksionet përkatëse të këtij pozicioni, si dhe shkaqet e riklasifikimit dhe mos përfshirjes së tij në skemën e shërbimit civil.

- Punonjësja *****, emëruar në pozicionin “*Sekretar/arkiv*”, në njësinë Administrative Fratar, me aktin nr. 451, datë 21.09.2020.

Sipas strukturës aktuale rezulton se ky pozicion është përfshirë në skemën e shërbimit civil, por nga ana tjetër, konstatohet se ky pozicion kryen njëkohësisht funksione administrative (sekretari), të cilat përjashtohen nga veprimi i ligjit për shërbimin civil. Në këto kushte, vlerësohet se njësia përgjegjëse duhet të riklasifikojë këtë pozicion pune, duke analizuar dhe përcaktuar detyrat funksionale, si dhe të vendosë nëse pozicioni i punës do të përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil. Vetëm në përfundim të këtij procesi, Komisioneri mund të shprehet në lidhje me ligjshmërinë e aktit të emërimit për nëpunësen në fjalë.

- Punonjësja *****, emëruar në pozicionin “*Specialist i çështjeve shëndetësore*”, me aktin nr. 519, datë 16.11.2020;
- Punonjësi *****, emëruar në pozicionin “*Specialist i zyrës me një ndalesë*”, me aktin nr. 139, datë 31.05.2021.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij vendimi, është konstatuar se pozicionet e mësipërme janë përfshirë në skemën e shërbimit civil, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe si rrjedhim, është kërkuar që njësia

përgjegjëse të riklasifikojë këto pozicione, duke ndryshuar regjimin juridik të marrëdhënies së punësimit. Për këto arsye, Komisioneri çmon të mos shprehet në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së emërimit për të dy punonjëset e mësipërme.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshme, 24 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, konkretisht:
 - ✓ ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm”, emëruar me aktin nr. 452, datë 21.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Njesisë së Integritit European”, emëruar me aktin nr. 137, datë 31.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Njesisë së Integritit, emëruar me aktin nr. 27, datë 28.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Specialist i ndihmës ekonomike”, në Njesisë Administrativ Ballsh, emëruar me aktin nr. 391, datë 10.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Specialist i dhunës në familje, mbrojtjes së fëmijëve, barazisë gjinore dhe mbrojtjes sociale”, emëruar me aktin nr. 390, datë 10.08.2020 të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, me aktin nr. 843, datë 02.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore”, emëruar me aktin nr. 97, datë 28.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Specialist jurist”, në Sektorin Juridik, emëruar me aktin nr. 94, datë 28.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
 - ✓ ***** , në pozicionin “Specialist transporti”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 167, datë 25.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë;

- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist inxhinier*”, në Sektorin e Planifikimit, Projektimit dhe Lejeve të Ndërtimit, emëruar me aktin nr. 407, datë 27.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist zyre*”, në Sektorin e Kadastrës, emëruar me aktin nr. 454, datë 21.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shërbimit Veterinar*”, emëruar me aktin nr. 69, datë 30.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Përgjegjës i Sektori të Pyjeve dhe Mjedisit*”, emëruar me aktin nr. 441/1, datë 09.12.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist pyjesh dhe zonave mbrojtura*”, emëruar me aktin nr. 459, datë 24.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist pyjesh dhe zonave të mbrojtura*”, emëruar me aktin nr. 96, datë 09.4.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist muzike*”, emëruar me aktin nr. 453, datë 21.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist muzike*”, ”, në Sektorin e Kulturës, Sportit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 145, datë 04.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Kulturës, Sportit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 384, datë 10.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist i turizmit*”, në Sektorin e Kulturës, Sportit dhe Turizmit, emëruar me aktin nr. 315, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Njësinë Administrative Fratar, emëruar me aktin nr. 60, datë 01.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist kadastrë, agronom*”, në Njësinë Administrative Fratar, emëruar me aktin nr. 1, datë 05.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist i tatim taksave*”, në Njësinë Administrative Fratar, emruar me aktin nr. 330, datë 30.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist pyjesh dhe zonave të mbrojtura*”, në Njësinë Administrative Fratar, emëruar me aktin nr. 110, datë 30.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ***** , në pozicionin “*Specialist protokoll*”, emëruar me aktin nr. 77, datë 19.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë.

2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit aktualisht janë vakante ose rezultojnë të plotësuar në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013,

“Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit.

3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, duhet të tregojë kujdes në krijimin e një strukture organizative, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar si më poshtë:
 - ✓ Për pozicionet e punës “*Specialist i zyrës me një ndalesë*”, “*Specialist informacioni, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse (receptionist)*”, “*Përgjegjës i Sektorit të Arsimit dhe Shëndetit Parësor*”, “*Specialist i çështjeve arsimore*” dhe “*Specialist i çështjeve shëndetësore*”, duhet të analizojë detyrat dhe kompetencat për të përcaktuar nëse këto pozicione kryejnë funksione të njësive publike direkte të shërbimit dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e tyre ose jo, në skemën e shërbimit civil.
 - ✓ Për pozicionet e punës “*Specialist pyjesh*”, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, duhet t’i riklasifikojë si pozicione që përfshihen në skemën e shërbimit civil dhe më pas, të marrë masa për plotësimin e tyre, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - ✓ Për pozicionin e punës “*Drejtor i Mbrojtjes Civile dhe Territorit*”, duhet të ndajë nga njëra tjetra funksionet e mbrojtjes së territorit dhe atë të emergjencave civile, nëpërmjet analizimit të detyrave për secilin funksion dhe në përfundim të këtij procesi, të përfshijë në skemën e shërbimit civil, pozicionet e punës, që do të kryejnë funksionet e emergjencave civile.
 - ✓ Të krijojë njësi organizative në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, duke respektuar parimin e unitetit dhe hierarkisë administrative, të llogaridhënies si dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, me qëllim grupimin e pozicioneve me funksione të ngjashme në të njëjtën njësi organizative, si sektorë dhe/ose drejtori.
 - ✓ Të parashikojë në strukturë pozicionin e punës, i cili duhet të kryejë detyrat e nëpunësit më të lartë civil, me qëllim që të garantohet ligjshmëria e procesit të hartimit dhe miratimit të përkrahjeve të punës, e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe të procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit.

4. Për kryerjen e veprimeve administrative në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit për **24** punonjës dhe për realizimin e procedurave të konkurrimit për këto pozicione (*pika 1 dhe 2 e dispozitivit të vendimit*), lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim.

Për kryerjen e veprimeve administrative të përcaktuara në pikën 3 të dispozitivit, lihet afat deri në miratimin e buxhetit të vitit 2021, nga Këshilli Bashkiak.

Me kalimin e afateve të përcaktuara në paragrafët e mësipërm, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Mallakastër, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar dokumentacionin shkresor.

5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha